16 tetor 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 23.06.2026, dhe Rregullores Disiplinore ("RrD"), si dhe sipas Ankesës së KB Sigal Prishtina të datës 14.10.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), me datë 16.10.2026 merr ketë:

V E N D I M

I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 14.10.2026;

II. REFUZOHET Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 14.10.2026 si e PABAZUAR;

III. VËRTETOHET Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 08.10.2026.

A R S Y E T I M

Më datë 15.10.2026, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga Sekretaria e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Sigal Prishtina të datës 14.10.2026 (tash e tutje "Ankesa"). Ankesa bëhet ndaj Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 08.10.2026, (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me incidentin e ndodhur pas ndeshjes së zhvilluar më datë 04.10.2026 në mes të KB Sigal Prishtina dhe KB Golden Eagle Ylli.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 16.10.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Sigal Prishtina, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës.

Sipas kuptimit të KAA, KB Sigal Prishtina sfidon Vendimin e KD të identifikuar më sipër duke aluduar ndër të tjera se KD ka bërë shkelje esenciale të procedurës dhe të drejtës për t'u dëgjuar; se KB Sigal Prishtina nuk ka përgjegjësi sipas Nenit 46(1)(p); dhe se ka mungesë të arsyetimit dhe matje të gabuar të masës ndaj z. Gentian Rexhepi.

Bazuar në ato të cekura si më sipër, KB Sigal Prishtina kërkon ndër të tjera nga KAA që të:

I. APROVOHET ankesa e KB Sigal Prishtina si e bazuar.
II. ANULOHET në tërësi Vendimi i Komisionit Disiplinor të FBK-së i datës 08.10.2026.
III. Si kërkesë alternative: NDRYSHOHET Vendimi, duke e liruar KB Sigal Prishtina nga masa "Ndalesë e pranisë së shikuesve për 3 ndeshje" dhe

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

duke ulur masën ndaj z. Gentian Rexhepi në përputhje me praktikën e KD-së.

IV. Ankuesit i KTHEHET taksa prej 300€.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Sigal Prishtina ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të KD. Njëheri, KB Sigal Prishtina ka paguar edhe taksën obligative për parashtrim të ankesës. Rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet për pranueshmëri, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Lidhur me pretendimin për shkelje esenciale të procedurës dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, KB Sigal Prishtina ngre disa pretendime. Sa i përket pretendimit lidhur me kronologjinë e Vendimit (par. 8 i Ankesës), KAA vlerëson se i njëjti është i pabazuar. Konkretisht, në pjesën hyrëse të Vendimit të Komisionit Disiplinor, në referencën ndaj kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, është bërë një lëshim teknik në shënimin e datës, ku gabimisht është shënuar 07.10.2026, në vend të datës së saktë 05.10.2026. Ky pasaktësim paraqitet vetëm në atë pjesë të Vendimit, ndërsa datat e përmendura në pjesët e tjera të tij janë të sakta. KAA e ka verifikuar në mënyrë të pavarur këtë rrethanë. Për rrjedhojë, KAA vlerëson se ky pasaktësim teknik nuk e bën kronologjinë e procedurës të pamundur dhe pretendimi i KB Sigal Prishtinës në këtë pikë nuk qëndron.

Edhe pretendimi i KB Sigal Prishtina se nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar (para. 9 i Ankesës) nuk qëndron. Është vërtetuar nga KAA se është kërkuar deklarimi i KB Sigal Prishtina përmes emailës së datës 06.10.2026, duke i dhënë KB Sigal Prishtina një afat prej më shumë se 24 orë për tu deklaruar, dhe KB Sigal Prishtina ka dështuar të deklarohet dhe nuk ka ofruar ndonjë provë se është deklaruar brenda afatit. Nëse KB Sigal Prishtina dhe/ose z. Rexhepi kanë pasur nevojë për afat më të gjatë, ka mundur të kërkojë afat shtesë duke iu drejtuar KD-së me një kërkesë të tillë—që nuk e ka bërë. Krahasimi me raste të tjera që është bërë në Ankesë, nuk ka potencuar shkeljen e ndonjë dispozite të rregullativës ligjore, dhe rrjedhimisht nuk qëndron.

Edhe pretendimi i KB Sigal Prishtina se heshtja e KB Sigal Prishtina dhe/ose z. Rexhepi është përdorur kundër tyre (para. 11 i Ankesës) nuk qëndron. Një lexim i thjeshtë i Vendimit të KD tregon se në asnjë moment KD nuk e ka marrë mosdeklarimin si rrethanë rënduese ndaj dy palëve ndaj të cilave KD ka shqiptuar masat disiplinore përkatëse. Në të njëjtën kohë, mosdeklarimi i palëve në procedurë me vullnetin e tyre nuk mund të shërbejë më vonë si bazë për rrëzim të vendimeve.

ProCredit Bank TEB ART MOTION kujtesa SAVA automita RUGOVE
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

Në paragrafin 12 të Ankesës, KB Sigal Prishtina pretendon se KD ka cenuar procedurën për shkak se nuk ka shqyrtuar provat nga Policia e Kosovës. Mirëpo, KB Sigal Prishtina nuk potencon asnjë bazë ligjore që obligon KD të merr vendim vetëm pasi t'i ketë shqyrtuar provat eventuale që i ka mbledhë Policia e Kosovës. Procedura disiplinore në FBK është e pavarur nga procedura eventuale penale. KD vendos në bazë të provave dhe materialeve që ka në dispozicion; standardet dhe qëllimet e dy procedurave dallojnë. Thënë këtë, KAA vlerëson se ky pretendim i KB Sigal Prishtina është i pabazuar.

Edhe lidhur me pretendimin që KB Sigal Prishtina nuk ka përgjegjësi sipas Nenit 46(1)(p), KB Sigal Prishtina ngritë disa pretendime. Pretendimi i parë në këtë kategori është se KB Sigal Prishtina ka kryer tërë obligimin e vet dhe ka shmangur përgjegjësinë në plotni kur ka angazhuar Policinë e Kosovës (para. 13 i Ankesës). Mirëpo, KAA konsideron se angazhimi i Policisë, si akt, nuk e përjashton automatikisht përgjegjësinë e klubit. Sipas pikës 16.5.2 të Propozicioneve të Garave, zyrtari për siguri ka detyrime konkrete për sigurinë dhe largimin e sigurt të ekipit mysafir dhe zyrtarëve të ndeshjes, si dhe për bashkëpunimin me Policinë dhe sigurimin privat. Për më tepër, fakti qëndron se z. Rexhepi ka pozitë zyrtare në klub dhe kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e klubit për detyrimet e veta.

KAA vlerëson se pretendimi i ngritur nga KB Sigal Prishtina në paragrafin 14 të Ankesës gjithashtu nuk qëndron dhe është i pabazuar sepse i jep kuptim të gabuar Nenit 46(1)(p) të RrD. Kjo dispozitë thotë:

> Dështimi për të zbatuar të gjitha masat e nevojshme parandaluese për të shmangur shqetësimet apo trazirat, para, gjatë ose pas një loje, ose çdo situatë përfshirë mbi-kapacitetin që rrezikon mirëqenien dhe sigurinë e të pranishmëve, ose mungesa e forcave të sigurisë apo pasiviteti i personelit të sigurisë në palestër.

Në rastin konkret, kjo dispozitë nuk kufizohet vetëm brenda palestrës dhe parasheh situata të ndryshme, dhe rasti konkret bie pikërisht në kuadër të dispozitës. Fillimisht, incidenti gjenezën e ka brenda objektit, sepse sipas provave, fyerjet kanë filluar brenda objektit, ndërsa incidenti ka vazhduar pastaj jashtë objektit. KAA vlerëson se Rasti duhet vlerësuar në tërësi, jo vetëm sipas vendit ku ka përfunduar incidenti. Kjo lidhet edhe me pretendimin nga paragrafi 15 që KD ka vendosur përgjegjësi objektive, i cili nuk qëndron sepse përgjegjësia e klubit është vlerësuar nga KD në raport me detyrimet konkrete të klubit për organizimin dhe sigurinë, si dhe me Nenin 46(1)(p) dhe lidhet me mosveprimi e klubit për të siguruar ndeshjen dhe pjesëmarrësit zyrtar në ndeshje. Dhe lidhur edhe me paragrafin 16 të ankesës, KAA pajtohet me deklarimin se përgjegjësia e individit nuk transferohet automatikisht te klubi, mirëpo, KAA gjithashtu potencon se përgjegjësia individuale e

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

z. Rexhepi dhe përgjegjësia e klubit mund të ekzistojnë paralelisht, nëse plotësohen kushtet e rregullores, që në këtë rast janë plotësuar. Gjithashtu, KB Sigal Prishtina duhet të jetë e vetëdijshme se zyrtarët e të njëjtës kur ndërmarrin veprime që ndërlidhen me ndeshje, veprojnë jo vetëm si individë, por edhe si zyrtarë të klubit.

KAA ka shqyrtuar edhe pretendimet e bëra sa i përket shkeljes së parimit të trajtimit të barabartë, të shprehura nga KB Sigal Prishtina në paragrafët 17-19 të Ankesës. Të njëjtat KAA i vlerëson si të pabazuara sepse dy rastet duhet të vlerësohen sipas rrethanave konkrete, provave, natyrës së shkeljes, pasojave dhe rrethanave lehtësuese/rënduese. Trajtimi i barabartë nuk nënkupton masa identike në çdo rast në mënyrë automatike, por dallimet duhet të kenë arsyetim objektiv dhe të jenë të bazuara në rrethanat konkrete te rastit. Dhe KAA nuk sheh që KD ka bërë ndonjë shkelje kur ka aplikuar kornizën ligjore ndaj rrethanave konkrete të këtij rasti.

KB Sigal Prishtina gjithashtu ankohet lidhur me zbatimin e Nenit 48(1)(f), në paragrafin 21 të Ankesës. KAA vlerëson se KB Sigal Prishtina ka kuptim të gabuar të Nenit 48(1)(f) pasi që referenca te "pjesëmarrësi në ngjarjen sportive" lidhet me personin ndaj të cilit drejtohet veprimi, jo me vendndodhjen apo kohën e incidentit. Fakti që incidenti ka vazhduar jashtë palestrës dhe pas ndeshjes nuk e përjashton vetvetiu zbatimin e dispozitës.

Përfundimisht, edhe pretendimi i KB Sigal Prishtina që ndërlidhet me joproporcionalitet të masës disiplinore nuk qëndron. Masa përcaktohet brenda diskrecionit të KD-së, në kufijtë dhe sipas kritereve të Rregullores Disiplinore. Diskrecioni nuk nënkupton arbitraritet; masa duhet të jetë e arsyetuar dhe në përputhje me rrethanat e shkeljes. Në rastin konkret, KB Sigal Prishtina nuk ka provuar se KD ka shqiptuar ndonjë masë disiplinore në mënyrë aribtrare. Përkundrazi, KD ka shqiptuar masa të parapara qartazi nga RrD dhe në fakt ka treguar maturi duke mos shqiptuar masat më ekstreme që i ka pasur në diskrecion. Rrjedhimisht, KAA nuk mund të ndërhyjë duke cenuar diskrecionin që KD e gëzon në vendimmarrje disiplinore.

KAA ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të KB Sigal Prishtina në këtë Ankesë, dhe i ka konsideruar si të pabazuara dhe si të tilla, i refuzon.

Prandaj, KAA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

Komisioni i Arbitrazhit:

Partin Pruthi	Korab R. Sejdiu	Lulzim Fushtica
Anëtar	Kryetar	Anëtar

Prishtinë, 16 tetor 2026

Vendimi i dërgohet:

- KB Sigal Prishtina
- Komisionit Disiplinor të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO
FBK
PRISTINA
PRISTINA
PRISHTINË

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës